



KUVENDI I SHQIPËRISË
Komisioni për Politikën e Jashtme

Dokument parlamentar

RAPORT

PËR PROJEKTLIGJIN

**“PËR RATIFIKIMIN E KONTRATËS FINANCIARE, NDËRMJET KËSHILLIT TË
MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE BANKËS EVROPIANE TË
INVESTIMEVE, PËR PROJEKTIN “SHTRATI I LUMIT LANA – ZHVILLIM URBAN”**

- **Hyrje**

Komisioni për Politikën e Jashtme, në cilësinë e Komisionit për dhënie mendimi, në zbatim të neneve 32-38 të Rregullores së Kuvendit, shqyrtoi projektligjin “Për Ratifikimin e kontratës financiare, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Evropiane të investimeve, për projektin “Shtrati i Lumit Lana – Zhvillim Urban”.

Të pranishëm në mbledhjen e Komisionit për të prezantuar projektligjin dhe për t’u dhënë shpjegime pyetjeve të deputetëve ishin Zv. Ministra e Financave dhe përfaqësues të bashkisë Tiranë.

- **Baza kushtetuese e projektligjit**

Projektligji i paraqitur për shqyrtim është propozuar nga Këshilli i Ministrave, sipas përcaktimeve të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe shoqërohet me relacionin përkatës sipas nenit 68 të Rregullores së Kuvendit.

Ratifikimi i kësaj marrëveshje bazohet në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, Kreu II “Marrëveshjet Ndërkombëtare”, neni 121 i saj.

- **Qëllimi dhe përmbajtja e projektligjit**

Nëpërmjet këtij projektligji synohet ratifikimi i kontratës financiare, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Evropiane të Investimeve, për projektin “Shtrati i lumit Lana – zhvillim urban”. Kredia që akordohet nëpërmjet kësaj kontrate ka shumën 8 milionë euro, maturimi për 20 vjet me interes të përcaktueshëm mbi bazën e tregut në momentin e disbursimit, duke përfshirë një periudhë pa pagesë principali prej 4 vjetësh. Për bashkëfinancimin e këtij projekti BEI akordon, gjithashtu, edhe një grant në shumën 2, 4 milionë euro. Nëpërmjet këtij financimi synohet të realizohet zgjatimi i bulevardit nga Ura Teknologjike (ku përfundon aktualisht segmenti ekzistues) deri në kryqëzimin me rrugën “Teodor Keko” dhe rehabilitimin e shtratit të lumit Lana po për këtë segment. Nëpërmjet këtij projekti mundësohet krijimi i një shtrati me regjim hidraulik eficient, për të eliminuar problematikën e përmytjeve në këtë zonë, si dhe krijimin e hapësirave të nevojshme të zhvillimit urban të zonës. Për **zbatimin** e këtij projektligji ngarkohen Bashkia e Tiranës dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë deri në shkurt të vitit 2022.

Për sa i takon **efekteve financiare**, nisur nga plani i veprimit dhe i implementimit të këtij projekti, vlera e tij do të mbulohet nga shpenzimet buxhetore të Bashkisë Tiranë, dhe do të jetë e shpërndarë në 3 vite buxhetore duke nisur që nga viti buxhetor aktual.

- **Diskutimi në komision**

Të pranishëm në mbledhjen e Komisionit, për të shpjeguar nismën dhe për t’iu përgjigjur pyetjeve të deputetëve, ishin Zv. Ministria e Financave dhe përfaqësues të bashkisë Tiranë, të cilët sqaruan se ky projekt (rehabilitimi i lumit Lana në këtë segment dhe ndërtimi i zgjatimit të dy bulevardeve “Bajram Curri” dhe “Gjergj Fishta”) synon të ndikojë pozitivisht në zhvillimin e zonave përkatëse, duke siguruar një infrastrukturë të qëndrueshme, e cila do t’i shërbejë edhe zonave përreth saj dhe duke përmirësuar gjendjen tejet të amortizuar të infrastrukturës ekzistuese.

Deputetët kërkuar informacion lidhur me efektet financiare të projektligjit dhe garancitë që ofrojnë institucionet përgjegjëse për zbatimin e tij dhe pasi morën përgjigje nga përfaqësuesit e ministrisë vlerësuan nismën e propozuar dhe nevojën për përmbushjen e objektivave të këtij projekti.

Komisioni vlerësoi se **në aspektin ligjor**, projektligji i propozuar është në përputhje me Kushtetutën dhe legjisllacionin në fuqi dhe **në aspektin procedural**, është paraqitur në përputhje me Rregulloren e Kuvendit.

Në përfundim të diskutimeve, me votat e të gjithë anëtarëve të pranishëm e miratoi projektligjin në parim, nen për nen dhe në tërësi dhe u shpreh dakord për kalimin e tij për votim në seancë plenare.

RELATORE

EVIS KUSHI

KRYETARE

MIMI KODHELI